



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 70/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të mbulimit të posterave, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 28.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.04.2012, nga subjekti politik LDK, dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se personat nga subjekti politik PDK, dega në Ferizaj, kanë mbuluar gjysmën e posterit të kandidatit për kryetar të komunës së Ferizajt, nga radha e subjektit politik të LDK-së, me posterin e kandidatit për kryetar të komunës së Ferizajt, nga subjekti politik PDK.

Parashtruesi i ankesës propozon, që të ndërmerren masat e parapara ligjore ndaj subjektit politik PDK, dega Ferizaj.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur ankesës asnjë provë.

Neni 118 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se ankesa është e pabazuar, për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 3 paragrafi 6 pika (c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ngase parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë në mbështetje të pretendimeve të tij. Për këto arsye bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore dhe në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 70/2012 më datën 28.04.2012.

**Kryesuesi i panelit
Muhamet Rexha**

